



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS  
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2023:188238  
Datë: 11.01.2024  
Numri i dokumentit: 05178392

**C-III-23-0272**

*Paditësi*

**M S I** të cilin sipas autorizimit e përfaqëson avokate, N H, nga Prishtina

*kundër*

*Të paditurat*

- 1. PTP “3” D.O.O.**, nga Çagllavica, Komuna Graçanicë, e cila përfaqësohet nga B R, M M dhe N R
- 2. NSH “Përparimi”** (emërtim i mëhershëm NSH “Napredak”), të cilën e përfaqëson në cilësi të administruesit - **Agjencia Kosovare e Privatizimit – (AKP)**, Rr. “Dritan Hoxha” 55, Lakrishte, Prishtinë

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), Kolegji i përbërë nga Gazmend Sylaj gjyqtar kryesues, Diellza Hoxha gjyqtare dhe Agron Hoxha gjyqtar, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 11 janar 2024, merr këtë:

**AKTVENDIM**

- 1. Kërkesëpadia si dhe propozimi mbi lëshimin e Masës së Sigurisë lidhur me lokalin afarist, i cili gjendet në Prishtinë, .., kati përdhësë, në sipërfaqe prej 21.66 metra katrorë sipas Kontratës nr. ..datë .. prill., hedhet si e papranueshme.**
- 2. Secila palë i bartë shpenzimet e veta.**

## **Rrethanat faktike dhe procedurale**

Paditësi me 5 shtator 2023, parashtroj padi me propozim për lëshimin e masës së sigurisë ( në tekstin në vijim MS), pranë Gjykatës themelore në Prishtinë ( në tekstin në vijim GJTHP).

Paditësi, me padi, kërkoj njohjen e së drejtës së pronësisë së lokalit afarist, i cili gjendet në Prishtinë, nr. ..., kati përdhese, në sipërfaqe prej 21,66 metra katrorë ( në tekstin në vijim PRONA KONTESTUESE), lokal ky i ndërtuar sipas Kontratës mbi bashkimin e mjeteve për ndërtimin e hapësirave afariste, nr. .datë .. prill .., të ndërtuara në ngastrat kadastrale nr. ...dhe ... Zona Kadastrale Prishtinë.

Me propozimin për lëshimin e MS, kërkoj që i padituri i parë (1), të urdhërohet që mos të ndërmarr asnjë veprim në PRONËN KONTESTUESE, e me çka do të dëmtohej kjo pronë.

Duke vepruar sipas kërkesës së GJTHP, AKP me shkresën e saj drejtuar gjykatës, pretendon se NSH “Përparimi” ( ish NSH “Napredak”) është pronare e ngastrave kadastrale nr..., ..dhe... Zona Kadastrale Prishtinë, dhe kërkoj nga GJTHP që të shpallet jo - kompetente lidhur me çështjen.

GJTHP me Aktvendimin e saj, C.nr.4964/2023 datë 4 tetor 2023, është shpallur jo -kompetente dhe lënda është referuar pranë DHPGJS për vendosje.

Lënda në DHPGJS është regjistruar me 7 nëntor 2023.

Duke vepruar sipas urdhrit të gjykatës, përfaqësuesja e paditëses me parashtrësën e dorëzuar pranë DHPGJS me 17 nëntor 2023, parashtroj një kopje të fletës poseduese, datë .. nëntor.., për ngastrat..dhe.., Pronë shoqërore shfrytëzuese Industria e Mobileve Napredak dhe një kopje të skicës së ngastrave kadastrale.

Sipas urdhrit të gjykatës, AKP me 14 nëntor 2023, parashtroj përgjigje dhe pohoj se NSH “Përparimi” është pronare e ngastrave kadastrale nr..., ..dhe... AKP tutje pohon se objekt i shqyrtimit të kërkesës sipas padisë së paditësit, është pronë shoqërore dhe se ajo administron këto asete. Përgjigjes i janë bashkangjitur, një kopje të Vendimit të Autoritetit të Likuidimit, PRN111-0126 datë 10 qershor 2021, kopje të certifikatës së drejtave pronësore dhe kopje skicë të ortofotos së ngastrave kadastrale.

Me Aktvendimin e gjykatës, datë 21 nëntor 2023, kërkesa e AKP – të paditurës së dytë u aprovua dhe e njëjta është shtuar si palë në cilësinë e të paditurës lidhur me ketë çështje.

Duke vepruar sipas urdhrit të gjykatës, datë 21 nëntor 2023, e paditura e dytë – AKP parashtroj përgjigjen e saj ndaj propozimit mbi lëshimin e MS.

E paditura e dytë – AKP me përgjigjen e saj pohoj se paditësi me propozimin mbi MS nuk ka ofruar prova të besueshme nga të cilat vlerësohet e drejta e tij pronësore në pronën kontestuese e ndaj së cilës pronë kërkohet lëshimi i MS. AKP përfundimisht pohon se propozimi mbi lëshimin e MS nuk i ka plotësuar kushtet ligjore të parapara sipas nenit 61.1 të Ligjit ( nr. 06/L-86) për DHPGJS andaj edhe propozoj që kërkesa të refuzohet si e pabazuar.

Padia me propozimin mbi MS është tentuar ti dorëzohet të paditurit të parë - PTP “3” D.O.O., me 23, 24 dhe 27 nëntor 2023 si dhe me 5, 6 dhe 8 dhjetor 2023. Në të gjitha këto tentime është shënuar shënim: “*i panjohur*”.

Me 8 dhjetor 2023, gjykata lëshoj një urdhër për paditësin me të cilin u informua se padia duhet të përmbajë adresën e saktë të paditurit të parë, PTP “T” D.O.O., andaj u kërkuar përmbushja e urdhrimit.

Me parashtresën datë 8 dhjetor 2023, përfaqësuesja e paditësit paraqiti një shtesë të adresës së të paditurit të paraqitur me padi, sikur se “*lagja h*”- “*shtëpia e e Z M*”.

Gjykata, duke vepruar sipas parashtresës së cekur si më lartë, tentoi prapë me anë të urdhrimit, datë 19 dhjetor 2023, që padinë me propozim mbi MS të ja dorëzoj të paditurit të parë, PTP “3” D.O.O, por prapë pa sukses.

### **Arsyetimi ligjor**

Bazuar në nenin 36.2 paragrafi 2.6 të Ligjit për DHPGJS një padi/kërkesë/ankesë mund të konsiderohet si e pranueshme, nëse:

*“padia/kërkesa/ankesa është parashtruar në pajtim me nenin 33 dhe 35 të këtij ligji”.*

Tutje sipas nenit 35.2 paragrafi 2.3 të Ligjit për DHPGJS ( *nisja e procedurave* ), thuhet:

*“padia duhet të përmbajë emrin dhe adresën e saktë të paditurit, deri në atë masë sa përcaktohet me paragrafin 2 të nenit 25 së këtij ligji ”.*

Paditësi edhe përkundër tentimeve të gjykatës mbi dorëzimin e padisë dhe MS si dhe tentimeve të gjykatës përmes urdhrimit drejtuar paditësit, i njëjti nuk ka vepruar sipas nenit së cekur si më lartë si dhe nuk ka vepruar sipas paragrafit 2 nenit 25 të Ligjit për DHPGJS me çka të paditurit të parë, PTP “3” D.O.O, do ti mundësohej të informohej mbi një procedurë gjyqësore e cila zhvillohej ndaj tij si dhe do ti mundësohej që të deklarohej me përgjigje, si ndaj Padisë e gjithashtu edhe MS.

Në rastin konkret, pasi që pala paditëse nuk i ka përmbushur kushtet e parapara ligjore të cekura si më lartë, palës së paditur, PTP “3” D.O.O, nuk është arritur ti dorëzohet padia me MS njëherit edhe i është pamundësuar që të deklarohej.

Mos dhënia e mundësisë që të paditurit të informohet/n dhe të deklarohej/n paraqet shkelje të parimit “*audiatur et altera pars apo audi alteram partem*” ( *le të dëgjohet edhe pala tjetër*) andaj edhe në kuptim të dispozitave të lartë cekura ligjore të Ligjit për DHPGJS konsiderohet e papranueshme.

Paditësi gëzon të drejtën që parashtrorë padi të re, por gjithnjë në pajtim me nenin 35.2 të Ligjit për DHPGJS.

## **Shpenzimet**

Paditësi ka paguar taksat gjyqësore, pranë GJTHP.

Në pajtim me nenin 62 të Ligjit për DHPGJS, secila palë i bartë shpenzimet e veta.

Andaj u vendos si në dispozitiv.

## **Këshilla ligjore**

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të DHPGJS brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktvendimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për DHPGJS.

Gazmend Sylaj, Gjyqtar kryesues \_\_\_\_\_

Diellza Hoxha, Gjyqtare \_\_\_\_\_

Agron Hoxha, Gjyqtar \_\_\_\_\_